



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 21 Shkurt 2017

Njoftim

Fondit për sigurim shëndetësor më afër penzionerëve

Drejtorët e Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë, Orhan Ramadani dhe dr.Sasho Stefanoski, për herë të parë këtë vit realizuan takim me kryetarin e Shoqatës së penzionerëve të Maqedonisë, Dragi Argirovski dhe me anëtarë tjerë të Shoqatës së penzionerëve të Maqedonisë.

Temë diskutimi në takimin e sotshëm ishte identifikimi i nevojave të Shoqatës së penzionerëve të Maqedonisë, planet e ardhshme dhe përcaktimi i qartë i bashkëpunimit me Fondin për sigurim shëndetësor në vitin 2017. Përfaqësuesit e Shoqatës së penzionerëve të Maqedonisë informuan për temat të cilat janë me interes të veçantë për penzionerët si: barnat e listës pozitive pa kosto shtesë, të drejtat që rrjedhin nga Ligji për sigurimin shëndetësor, rehabilitimin e specializuar mjekësor dhe shërbimet tjera që i ofron Fondi.

Mes dy palëve të diskutimit, në mënyrë reciproke u vendos që përfaqësuesit e Shoqatës së penzionerëve të vazhdojnë me organizimin e punëtorive edukative me titull 'Fondi për sigurim shëndetësor në shërbim të penzionerëve', punëtori që realizohen në bashkëpunim me të punësuarit e Fondit. Ky aktivitet do të zhvillohet nëpër të gjithë territorin e Maqedonisë për gjatë vitit 2017. Orari edhe formati i punëtorive edukative do të jetë në pajtueshmëri mes të dy subjekteve dhe për të njejtën do të vendoset bashkërisht. Të gjithë të interesuarit do të jenë të informuar në kohë për terminin dhe vendin e zhvillimit të punëtorive edukative.

Drejtori dr. Sasho Stefanoski shprehi kënaqësi për bashkëpunimin e shkëlqyer që ka Fondi si me Shoqatën e penzionerëve ashtu dhe me shoqatat tjera joqeveritare. Fondi për sigurim shëndetësor i kushton vëmendje të madhe bashkëpunimit me të gjitha shoqatat e pacientëve dhe si rezultat i krijimit të një bashkëpunimi të tillë, Fondi krijoi besim dhe respek të ndërsjelltë gjithnjë duke synuar qëllimin e përbashkët 'shërbime shëndetësore me kualitet të mirë, pacientë të kënaqur'. Drejtori Stefanoski theksoi se penzionerët janë një ndër vëzhguesit cilësor të sistemit shëndetësor në terrësi, si në Republikën e Maqedonisë ashtu edhe më gjërë dhe faleminderoi Shoqatën e penzionerëve të Maqedonisë për angazhimin dhe propozimet e tyre cilësore që kontribuojnë në sferën e shëndetësisë si dhe për rolin e tyre konstruktiv në gjetjen e zgjidhjeve efikase që janë në dobi të pacientëve.

Drejtori Orhan Ramadani potencoi se Fondi kontribuon për edukimin e personave të siguruar dhe se punëtoritë e tilla edukative, kanë për qëllim rritjen e nivelit të informimit të drejtë rreth të drejtave që rrjedhin nga Ligji për sigurimin e shëndetësisë si dhe për barnat që janë në listën pozitive. Timi i këtyre



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



punëtorive edukative përbëhet prej juristëve dhe mjekëve të FSSHM-së të cilët, para penzionerëve prezantojnë materijale me temat e përzgjedhura paraprakisht, duke ndarë një pjesë të kohës edhe për pyetjet e parashtruara nga ana e penzionerëve. Drejtori Ramadani njoftoi se në vitin 2017 punëtoritë do të zhvillohen nëpër 30 qytete të ndryshme të Maqedonisë respektivisht nëpër qytetet ku Fondi për sigurim shëndetësor i posedon Njësitë rajonale dhe Shoqata e pensionerëve i posedon shoqëritë e veta.